



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 4775, prot.

Datë 27/12/2024

VENDIM

Nr. 60, datë 23/12/2024

PËR  
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS TË  
BASHKISË FUSHË-ARRËZ, NJËSIVE ADMINISTRATIVE,  
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË  
DELEGUARA PËR VITIN 2025

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni "64 germa "J", neni "55", Ligjit 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në Institucionet e administratës publike, si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi, VKM nr. 503, datë 1.8.2024, Për disa ndryshime në VKM nr. 328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM nr. 422, datë 26.06.2024 Për një ndryshim në VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", VKM nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në Institucionet arsimore dhe në Institucionet plotësuese të sistemit arsimorë parauniversitar", VKM nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr. 502, datë 1.8.2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve të disa institucioneve të administratës publike", si dhe VKM nr. 113, datë 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në mbledhjen e tij të rradhës mori në shqyrtim projektin e vendimit dhe pas diskutimit nga Këshilltarët:

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë Fushë Arrëz, Njësive administrative, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Sektori i menaxhimi të burimeve njerëzore Sektori i Financës.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1 Janar 2025 deri 31 Dhjetor 2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Ky vendim mori:

**11** vota pro.

**0** Vota kundër.

**0** Vota abstenim.

Vendimi u shpall me datë 27/12/2024.

KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

